

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, në përbërje nga trupi gjykues – gjyqtari Naim Kurtishi kryetar i trupit, gjyqtarëve porotë Skender Cena e Lirije Turtulla anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Arlind Sharani, në çështjen juridike të paditëses V. T. e lindur D. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. F. B., nga Gjakova, kundër të paditurit Y. T. nga Prizreni, lidhur me zgjidhjen e martesës, pas shqyrtimit kryesor jo publik me datë 03.02.2016, mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**I. PJESËRISHT APROVOHET si e bazuar** padia e paditëses V. T. e lindur D. nga Prizreni.

**II. ZGJIDHET ME SHKURORËZIM MARTESA** e lidhur në mes të paditëses V. T. – D. dhe Y. T., e lidhur me dt..., e regjistruar me nr.ref... me nr.rend..., e lidhur pranë Ofiqarit të gjendjes civile në Prizren.

**III.** I mituri B. T. i lindur me dt..., i besohet në ruajtje, edukim dhe ushqimi të ëmës V. T. – D. nga Prizreni.

**IV. OBLIGOHET** paditësja V. T. që të paditurit Y. T. t'i mundësoj kontakt shiqimin me të miturin B. T. dhe atë çdo të shtunë të parë dhe të fundit të çdo muaji nga ora 10:00 gjerë në ora 16:00 gjersa të pushojnë kushtet ligjore.

**V. OBLIGOHET** i padituri Y. T. që në emër të alimentacionit për të birin B. T. të paguaj shumën prej 100 Euro, dhe atë në xhironlogarinë bankare të ëmës së tij V. T. e lindur D., në fillim të çdo muaji vijues më së voni deri me datën 05. të muajit vijues, duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi gjersa të pushojnë kushtet ligjore për dhënien e këtij alimentacioni, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

**VI.** Pjesa tjetër e padisë së paditëses V. T. e lindur D., përtej shumës së aprovuar në pikën V të dispozitivit të këtij aktgjykimi, **refuzohet si e pabazuar.**

**VII.** Secila palë i mban shpenzimet e veta të procedurës.

## **A r s y e t i m**

Paditësja V. T. e lindur D. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. F. B., pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi për zgjidhjen me shkurorezim të martesës të saj me Y. T. nga Prizreni, në të cilën ka kërkuar që të zgjidhet martesa e lidhur ndërmjet palëve ndërgjyqëse e lidhur në Prizren, ndërsa fëmija i mitur B. T. të i besohet në ruajtje, edukim dhe mbajtje nënës këtu paditëses si dhe të detyrohet i padituri që për fëmijun e mitur B. të i paguajë shumën prej 200€ në muaj, që nga dita e parashtrimit të kësaj padie deri sa të ekzistojnë kushte ligjore, duke theksuar se palët ndërgjyqëse kanë lidhur kurorë para organit kompetent në Prizren, me datë 31.01.2014, dhe nga kjo martesë kanë një fëmijë të mitur B. T.

Paditësja me të paditurin nuk kanë raporte të mira në mes vete, duke shkaktuar tronditje të thellë dhe serioze të përhershme të raporteve bashkëshortore, andaj nga kjo situatë të krijuar paditësja dëshiron që të shkurojë me të paditurin. Paditësja me fëmijën e mitur tani jetojnë në shtëpinë e prindërve të saj të cilët kanë kushte të mira jetësore dhe kanë mundësi të kujdesen për fëmijën e mitur, duke theksuar se kërkon alimentacion për të miturin djalin e tyre në shumën prej 200€ në muaj, ndërsa i padituri është i punësuar dhe ka mundësi të pagesës, duke propozuar Gjykatës që pas administrimit të provave ta aprovojë kërkesëpadinë.

I autorizuari i paditësit në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se ngel në tërësi në të dhënat që janë të cekura në padinë e shkruar në këtë gjykatë, dhe në të dhënat në shqyrtimin përgatitor, duke kërkuar që pas administrimit të provave të propozuara gjykata të vendos sipas ligjit. Ndërsa, edhe në fjalën fundit ka deklaruar se ngel në tërësi pranë padisë së parashtruar, dhe me aktgjykimin e kësaj gjykate të zgjidhet martesë ekzistuese, i mituri B. të i besohet në ruajtje dhe edukim ëmës së tij, e njëherit e njëjta të merr obligim për të siguruar kontakt shqimim me të atin Y. T. dhe atë siç e konsideron gjykata të arsyeshme, duke pasur parasysh mendimin e Qendrës për Punë Sociale, si dhe i padituri të paguajë alimentacion mujor për të miturin në shumën prej 200€ në muaj. Shpenzimet procedurale nuk i ka kërkuar.

I padituri, në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se ngel në tërësi në të dhënat që janë cekur nga shqyrtimi përgatitor, duke theksuar se raportet bashkëshortore janë rënduar përtej mase, të njëjtat nuk kanë mundësi të sanohen dhe vërtet me bashkëshorten nuk bashkëjetojnë nga Korriku i viti 2015, edhe përkundër dëshirës së tij që të vazhdohet për të bashkëjetuar dhe të ruhet kjo martesë, mirëpo ai nuk ka pasur sukses në këtë drejtim, duke theksuar se nuk pranon kërkesën për zgjidhjen e martesës, dhe e konteston të njëjtën. I padituri më tej ka theksuar se lidhur me besimin e të miturit B. T., nuk ka mundësi për të dhënë alimentacion më tepër se 50 euro në muaj, edhe pse më herët është deklaruar se mund të jap 100 euro, për faktin se nuk ka mundësi materiale për të dhënë këtë shumë që kërkohet, duke i propozuar gjykatës që të vendos konform ligjit. Edhe në fjalën e fundit e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses për zgjidhjen e martesës, duke mos e kontestuar faktin që i mituri B. T. mund të i besohet të ëmës këtu V. T., por edhe të atit këtu të paditurit, ndërsa lidhur me pagimin e alimentacion për momentin për shkak të obligimeve familjare nuk mund të jap më shumë se 50 euro në muaj për të birin B., me mundësi të rritjes së kësaj shume kur të përmirësohet gjendja financiare e tij. Shpenzimet procedurale nuk i ka kërkuar.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike dhe faktet vendimtare, gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave: ka bërë leximin e certifikatës së martesës me nr. ref... me nr. rendor ..., ka bërë leximin ekstraktit të lindjes me nr... e lëshuar në emër të B. T., ka bërë leximin e raportit - mendimin zyrtar i dhënë nga Drejtoria e përgjithshme e policisë, e dhënë nga kapiten H. T., dhe i dhënë si vërtetim për realizimin e të ardhurave personale nga reshteri policor Y. T., ka bërë leximin e raporti i dhënë me shkrim nga Qendra për Punë Sociale që është me nr.05-nr.1313 e dt. 12.01.2016.

Me leximin e certifikatës së martesës me nr. ref... me nr. rendor ..., vërtetohet fakti se paditësja V. T. – e lindur D. dhe i padituri Y. T., pranë ofiqarit të gjendjes civile në Prizren kanë lidhur martesë me datë ....

Me leximin e ekstraktit të lindjes ... e lëshuar në emër të B. T., i lindur me dt..., vërtetohet fakti se babai i fëmijës të mitur është Y. T. – i padituri dhe e ëma V. T. paditësja.

Me leximin e raportit - mendimin zyrtar i dhënë nga Drejtoria e përgjithshme e policisë, e dhënë nga kapiten H. T., dhe i dhënë si vërtetim për realizimin e të ardhurave personale nga rreshteri policor Y. T., gjykata ka vërtetuar se i padituri si zyrtar policor është i punësuar me orar të plotë në Policinë e Kosovës që nga data 29 Nëntor 1999, dhe si zyrtar policor realizon pagë mujore prej 563.31 euro.

Me leximin e raportit i dhënë me shkrim nga Qendra për Punë Sociale që është me nr.05-nr.1313 e dt. 12.01.2016, gjykata ka vërtetuar se Qendra ka dhënë mendimin e saj se martesë ndërmjet palëve ndërgjyqëse mund të zgjidhet, ndërsa lidhur me besimin e të miturit B. T., duhet të i besohet të ëmës në ruajtje dhe kujdes dhe se të atit të të miturit t'i mundësohet kontakt shiqimi.

Me vlerësimin e gjithmbarshëm të të gjitha provave të nxjerrura në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e **bazuar**.

Nga provat e administruara më lart dhe faktet e vërtetuara, gjykata bëri vlerësimin për të dhënave nga paditësja dhe i autorizuari i saj si dhe të paditurit, vlerësimin e provave materiale, dhe pasi që i hetoi të gjitha rrethanat e rastit, gjykata ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për zgjidhjen e kësaj martesë në kuptim të nenit 69 të Ligjit për Familjen i Kosovës, për shkak se marrëdhëniet bashkëshortore janë çrregulluar në mënyrë serioze dhe të vazhdueshme, pas lindjes së djalit të tyre, dhe mungesës së harmonisë në mes bashkëshortëve dhe familjes së paditurit, për shkak të botëkuptimeve të ndryshme dhe mospërputhjes së karaktereve lidhur me zgjidhjen e situatave në familje. Gjykata ka vlerësuar që bashkësia martesore ndërmjet ndërgjyqësve nuk është e mundur, të cilën bashkëshortët e kanë manifestuar edhe me mos interesimin që të rivendosin bashkëjetesën martesore, dhe për më tepër duke u bazuar në faktin se bashkëshortët që një kohë gjatë nuk jetojnë në bashkësi faktike martesore, ngase paditësja jeton te familja e prindërve të saj, pasi që nuk kanë mundur të i zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre me të paditurin, andaj edhe kjo bashkësi martesore ka humbur qëllimin dhe efektin e vet për të cilën është lidhur dhe nuk ka arsye që kjo bashkësi martesore vetëm formalisht të vazhdojë. Në anën tjetër, për rivendosjen marrëdhënies bashkëshortore nuk ekzistojnë mundësit reale, duke pasur parasysh periudhën për të cilën bashkëshortët nuk komunikojnë në mes veti dhe nuk jetojnë bashkë. Përveç kësaj, gjykata ka konstatuar se martesë duhet të mbahet vetëm kur ekziston dashuria e ndërsjellët e bashkëshortëve, e cila shfaqet në një bashkëjetesë të harmonishme dhe për këtë nuk mjafton vetëm dëshira e njërit bashkëshort, andaj bazuar në këto fakte gjykata konsideron se janë plotësuar kushtet ligjore për zgjidhjen e martesës në mes të bashkëshortëve – palëve ndërgjyqëse dhe vendosi si në dispozitivin nën II të këtij aktgjykimi.

Ndërsa, lidhur me pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, gjykata vendosi në kuptim të nenit 140 par. 1 të Ligjit për Familjen e Kosovës, që fëmija e mitur B. T. t'i besohen në ruajtje, përkujdesje dhe edukim të ëmës V. T. e lindur D., pasi që u konstatua se pas përkeqësimit të marrëdhënies bashkëshortore, paditësja së bashku me fëmijën e saj ishte larguar në shtëpinë e prindërve të saj në Prizren, në të cilën shtëpi ajo vazhdon të jetoj, ku ekzistojnë kushtet të përshtatshme dhe të mjaftueshme për banim, andaj prej asaj kohe fëmija i mitur është në përkujdesje të nënës e saj. Gjithashtu, nga kjo duhet theksuar faktin se Qendra për Punë Sociale ka propozuar që fëmija i mitur t'i besohet të ëmës në ruajtje, kujdes dhe edukim, andaj bazuar në këto fakte si dhe pohimin e të paditurit i cili nuk e ka kontestuar

që fëmija i mitur t'i besohet ruajtje dhe kujdes të ëmës këtu paditëses, gjykata ka vendosur si në dispozitiv nën III të këtij aktgjykimi. Përveç kësaj, gjykata vendosi që të rregullohet edhe mbajtja e kontaktit të fëmijës së mitur me të atin e tij, bazuar edhe në mendimin e Qendrës për Punë Sociale në Prizren, andaj vendosi si nën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi e në kuptim të nenit 140 par. 1 të Ligjit për Familjen i Kosovës.

Në anën tjetër, sa i përket pikës V të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që nga provat e administruara Gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet ligjore që i padituri ka për obligim t'i paguajë paditëses për të miturin birin e tij B. T. në emër të alimentacionit shumë prej 100 euro për çdo muaj. Në këtë drejtim neni 290 paragraf. 1 i Ligjit për Familjen i Kosovës thotë se "Prindërit janë të detyruar të ofrojnë mbajtje financiare për fëmijët e tyre të mitur", ndërsa neni 299 parasheh "Bashkëshorti i ndarë mund të kërkojë ushqiminë nga bashkëshorti tjetër përderisa ai do të kujdeset dhe e mban fëmijën e përbashkët dhe për këtë arsye i bëhet e pamundur të punoj". Pra në rastin konkret, për deri sa paditësja është e pa punë, jeton tek prindërit e saj, dhe se për të dhe fëmijun e saj kujdesen familja e saj, përderisa, në anën tjetër gjykata konsideron se i padituri është në gjendje të kontribuoj në mirëmbajtjen e fëmijës së mitur, andaj kjo e arsyeton faktin se i padituri është në marrëdhënie të rregullt pune, ku është i punësuar si polic-rreshter në Policinë e Kosovës, dhe për këtë punë ai realizon të ardhura personale mujore në shumën bruto prej 563.31 euro, andaj nga këto të ardhura që i realizon i padituri mundet të i ndajë në shumën mujore prej 100 euro dhe kjo të mos e cenojë dhe të e ngarkojë buxhetin e të paditurit. Së këndejmi, gjykata vlerëson se vëllimi i mbështetjes duhet të jetë i përshtatshëm në kushtet në të cilat ka jetuar dikur i mituri, ndërsa alimentacioni i dhënë duhet të paktën të sigurojë një minimum të kushteve të cilat janë të domosdoshëm për jetesë, duke përfshirë kushtet e nevojshme të cilat duhet të kënaqin kushtet elementare të miturit B. T.

Andaj, bazuar nga të lart theksuarat dhe duke marr parasysh nevojat e fëmijës së mitur, moshën e tij, si dhe mundësit reale të përmbushjes nga ana e të paditurit, në kushtet dhe rrethanat tona, mendimi i gjykatës është se pagimi i shumës së lartcekur si në dispozitivin të pikës V të aktgjykimit është real dhe i arsyeshëm.

Gjykata vendosi si në pikën V të dispozitivit të aktgjykimit, duke e aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë, pasi konsideroi se shuma e gjykuar në emër të alimentacionit në shumën prej 100 euro, në muaj është reale dhe e mjaftueshme për kushtet, rrethanat dhe mundësit financiare që ka këtu i padituri për të përmbushur këtë obligim, ndërsa shuma e ngelur e të ardhurave mujore në shumën prej 463 euro, i mjaftojnë të paditurit për plotësimin e nevojave të veta dhe anëtarëve të tjerë të familjes.

Ndërsa lidhur me pikën VI të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata konsideroi se pjesa tjetër e kërkesëpadisë përtej shumës së aprovuar është e pa bazuar, për arsye se e ëma – paditësja është në moshë të re, është e aftë për të punuar dhe për të fituar të ardhura, duke punuar në bazë të aftësive të saj, dhe kontribuar në mbajtjen e të birit të saj.

Gjykata, gjithashtu ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Ndërsa, bazuar në deklaratën e autorizuarit të paditëses, se nuk i kërkojnë shpenzimet e kësaj procedure, gjykata vendimi mbi shpenzimet e kësaj procedure e ka marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së dhe nenit 347 të LFK-së, dhe vendosi që secila palë t'i bart shpenzimet e veta procedurale.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**C.nr.890/15, datë 03.02.2016**

**B. Profesional**  
**Arlind Sharani**

**Kryetari i trupit - Gjyqtari**  
**Naim Kurtishi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.